

VENDIM
Nr. 257, datë 20.4.2023

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 23, DATË 18.1.2023, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR FINANCIMIN E SHËRBIMEVE SHËNDETËSORE
SPITALORE NGA SKEMA E DETYRUESHME E SIGURIMEVE TË KUJDESIT
SHËNDETËSOR, PËR VITIN 2023”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023”, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 10383, datë 24.2.2011, “Për sigurimin e detyrueshëm të kujdesit shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pika 17, e vendimit nr. 23, datë 18.1.2023, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“17. Numri i pedagogëve me kontratë shërbimi për spitalet universitare miratohet çdo vit nga ministri i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale. Masa e shpërblimit mujor të mjekëve pedagogë të Universitetit të Mjekësisë, Tiranë, bazohet në aktivitetin mjekësor dhe kohën e angazhimit në strukturat shëndetësore universitare dhe nuk mund të jetë më e lartë se masa e shpërblimit mujor të drejtuesit të shërbimit me gradën “Doktor i shkencave.”.

2. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku